

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË MALIT TË ZI, PËR HAPJEN E PIKËS SË PËRBASHKËT TË KALIMIT KUFITAR ZOGAJ (REPUBLIKA E SHQIPËRISË) – SKJE (MALI I ZI) PËR QARKULLIMIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR DHE TË PASAGJERËVE NË LIQENIN E SHKODRËS”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, për hapjen e pikës së përbashkët të kalimit kufitar Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mali i Zi) për qarkullimin ndërkombëtar rrugor dhe të pasagjerëve në liqenin e Shkodrës.

Marrëveshja është iniciuar në kuadër të forcimit të bashkëpunimit midis dy shteteve dhe për të krijuar kushte sa më të mira për zhvillimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, në kuadër të lehtësimit të qarkullimit në pikën e përbashkët kufitare, duke marrë masa të përbashkëta.

Palët, me hapjen e kësaj pike të përbashkët të kalimit kufitar, synojnë të realizojnë objektivat e tyre lidhur me lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve dhe të mjeteve në zonat afër Bashkisë Shkodër dhe zonave të malësisë së Krajës, komuna e Tivarit - Mali i Zi, në kufirin tokësor dhe liqenor me Malin e Zi.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr.397, datë 2.7.2018, të Këshillit të Ministrave, dhe është nënshkruar nga palët.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është iniciuar nga pala malazeze dhe dakordësuar nga pala shqiptare, në kuadër të përmbushjes së prioritetëve të qeverisë shqiptare për lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve dhe mjeteve në këto zona.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje lidhen me lehtësimin e lëvizjes së banorëve të zonave afër Bashkisë së Shkodrës dhe zonave të Malësisë së Krajës, komuna e Tivarit - Mali i Zi, në të dyja anët e kufirit, shkurtimin e distancës, kontrollin më të mirë të sektorit të kufirit në zonën e Zogajt dhe veçanërisht kontrollin e bregut të liqenit të Shkodrës, si dhe shfrytëzimin e vlerave turistike të liqenit të Shkodrës dhe traditat e banorëve të Malësisë së Tivarit.

Palët do të ndërmarrin masa të përbashkëta dhe, sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje, do të konsultohen me njëra-tjetrën lidhur me problematikat që mund të lindin.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në përputhje me nenet 78, 83, 155 të Kushtetutës dhe është në harmoni me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk parashikon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Nga studimi i kryer nga Policia Kufitare, në kufirin me Malin e Zi, për lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve në zonën e Zogajt të Bashkisë Shkodër, është evidentuar se aty mund të hapet një vendkalim i ri për komunikim ndërkufitar tokësor dhe ujqor, në vendin e quajtur “Zogaj/Shkodër- Kraj/Mali i Zi”. Pika e kalimit kufitar Zogaj është një pikë e përbashkët e kalimit kufitar në Bashkinë e Shkodrës, në kufirin me Malin e Zi, e cila ndodhet 11 (njëmbëdhjetë) km në veriperëndim të qytetit të Shkodrës, në bregun e liqenit të Shkodrës.

Projektligji parashikon ratifikimin e marrëveshjes.

Në nenin 1 të marrëveshjes është parashikuar se qarkullimi i personave dhe i mallrave do të bëhet në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë dhe të Malit të Zi, ku lejohen vetëm kalime kufitare për qarkullim ndërkombëtar ose vende tjera të caktuara në marrëveshje ndërmjet palëve kontraktuese dhe se do të merren masat e duhura për ushtrimin e kontrollit në kuadër të mbylljes të të gjitha vendeve, të cilat nuk i përfshin si pika të ligjshme të kalimit kufitar.

Palët caktojnë pikën e kalimit të përbashkët kufitar për qarkullim ndërkombëtar dhe qarkullim të personave në liqenin e Shkodrës, Zogaj (Republika e Shqipërisë) – Skje (Mal i Zi), e cila do të ndërtohet në territorin malazez, në vendin e quajtur Ckla, në aksin rrugor Ostros – Shirokë - Shkodër.

Përparësitë që priten nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje janë në lidhje me lehtësimin e lëvizjes së banorëve të zonave afër Bashkisë së Shkodrës dhe zonave të Malësisë së Krajës, komuna e Tivarit - Mali i Zi, në të dyja anët e kufirit, shkurtimin e distancës, i cili ndikon gjatë sezonit turistik në uljen e fluksit të hyrjeve dhe daljeve në pikën e përbashkët të kalimit kufitar Muriqan, kontrollin më të mirë të sektorit të kufirit në zonën e Zogaj dhe veçanërisht kontrollin e bregut të liqenit të Shkodrës, si dhe shfrytëzimin e vlerave turistike të liqenit të Shkodrës dhe traditat e banorëve të Malësisë së Tivarit.

Parametrat teknikë përcaktohen nga komisioni i përbashkët, i cili do të fillojë të funksionojë pas përmbushjes së kushteve për funksionimin e rregullt ndërmjet shërbimeve kufitare të të dyja palëve.

Pika e përbashkët e kalimit kufitar do të jetë e hapur 24 orë në ditë për qarkullim ndërkombëtar rrugor dhe qarkullim të personave në liqenin e Shkodrës.

Kalimi i përbashkët kufitar është kalim në të cilin shërbimet e palëve kontraktuese, në kuadër të një bashkëpunimi sa më të suksesshëm, njëra pas tjetrës, bëjnë kontrollin hyrës dhe dalës, me një ndalje, duke i harmonizuar procedurat në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës dhe të kësaj marrëveshjeje, me qëllim të përsheptimit dhe thjeshtimit të procedurave kufitare të qarkullimit përmes kufirit të përbashkët shtetëror, si dhe racionalizimit të burimeve.

Në këtë marrëveshje ndërqeveritare për hapjen dhe funksionimin e pikës së kalimit kufitar janë marrë parasysh aspektet e rendit dhe të sigurisë publike, marrëdhëniet ekonomike dhe lidhjet ekzistuese ndërkufitare, qarkullimi i pritshëm dhe kapaciteti i

burimeve të përshtatshme njerëzore, për të plotësuar me personel pikën e kalimit kufitar.

Palët me anë të kësaj marrëveshjeje bien dakord se do të nënshkruajnë protokollin ku do të detajohen procedurat për zbatimin e kontrollit të përbashkët kufitar, çështjet teknike dhe financiare për ndërtimin dhe funksionimin e pikës së përbashkët të kalimit kufitar.

Mbikëqyrja e zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të kryhet nga Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve, i themeluar në bazë të ligjit nr.9702, datë 2.4.2007, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Malit të Zi për hapjen e pikës së përbashkët kufitare Muriqan-Sukobin. Komisioni, gjatë punës së tij, mund të përfshijë ekspertë të fushave të tjera dhe do të angazhohet në:

- a) përcjelljen dhe analizimin e zbatimit të marrëveshjes;
- b) përcjelljen dhe analizimin e frekuentimit të kalimeve kufitare, si dhe propozimin e masave dhe të veprimeve të duhura për përshtetimin e qarkullimit të pasagjerëve e të mallrave;
- c) shqyrtimin dhe zgjidhjen e të gjitha çështjeve të rëndësishme gjatë zbatimit të marrëveshjes;
- ç) dhënien e propozimeve organeve kompetente të palëve kontraktuese, plotësime, si dhe marrjen e masave për përmirësimin e kushteve për zbatimin e marrëveshjes.

Komisioni i Përbashkët i Ekspertëve do të takohet të paktën tri herë në muaj, sipas nevojës dhe radhës, në territorin e njërës dhe tjetrës palë.

Pajisjet dhe mjetet transportuese të nevojshme për punë në pikën e përbashkët të kalimit kufitar janë të përjashtuara me ligj nga detyrimet doganore.

Marrëveshja ngarkon me përgjegjësi për zbatim çdo nënshkrues të saj. Secila palë do të mundësojë pajisjet e nevojshme për zyrtarët e saj.

Marrëveshja është lidhur për një periudhë të pacaktuar kohore dhe secila palë mund ta zgjidhë marrëveshjen me shkresë diplomatike. Në këtë rast, kjo marrëveshje do të pushojë së aplikuari gjashtë muaj pas datës në të cilën pala tjetër ka marrë njoftimin për zgjidhjen.

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të kanaleve diplomatike, ku palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Parashikimet, sa më sipër, për hapjen e pikës së kalimit kufitar vijnë në përputhje me legjislacionin në fuqi (ligji nr.71/2016, “Për kontrollin kufitar”).

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për Republikën e Shqipërisë, autoritetet kompetent do të jetë Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Për qeverinë e Malit të Zi, autoriteti kompetent do të jetë Policia e Malit të Zi/ Ministria e Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes është hartuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Marrëveshja ngarkon me përgjegjësi për zbatim çdo nënshkrues të saj. Secila palë do të mundësojë pajisjet e nevojshme të komunikimit dhe ato teknike për zyrtarët e saj.

Kostot financiare të parashikuara në marrëveshje do të përballohen nga programi buxhetor “Policia e Shtetit”.

KËSHILLI I MINISTRAVE